

TAX Alert

Mars 2010

Me ligjin Nr. 10209, date 23.12.2009, Parlamenti Shqiptare aprovoje disa ndryshime ne Ligjin nr. 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise". Ndryshimet lidhen me ceshtjet e meposhtme:

Deklarimi elektronik (neni 3)

Sipas ndryshimeve te miratuara deklaratat tatimore do te paraqiten vetem ne menyre elektronike dhe Keshilli i Ministrave te Shqiperise eshte autoriteti kompetent per percaktimin e afateve kur deklarimet tatimore do te behen ne menyre elektronike.

Gjobat (neni 7/1)

Ndryshimet e miratuara parashikojne gjoba per mospagimin ne afat te detyrimeve te taksave. Keto gjoba do te jene 5% e shumes se detyrimeve te papaguara per secilin muaj apo pjese te muajit, gjate te cilit pagesa nuk eshte kryer, por gjoba nuk mund te jete me e madhe se 25 % e detyrimit te papaguar. Ne krahasim me dispoziten e meparshme eshte hequr percaktimi qe gjoba nuk mund te ishte me e vogel se 10,000 lek.

Ndryshim i deklarates tatimore (neni 7/2)

Ndryshimet e miratuara parashikojne gjoba per rastet e ndryshimit te nje deklarate tatimore te deklaruar me pare. Keto gjoba do te jene 5% e shumes se detyrimeve te pa paguara per sejcilin muaj apo pjese te muajit, gjate te cilit pagesa nuk eshte kryer por gjoba nuk mund te jete me e madhe se 25 % e detyrimit te pa paguar. Ne dispozitat e meparshme nuk parashikohet asnje gjobe per keto raste.

Mosdeklarimi i te punesuarve (neni 9)

Ndryshimet e miratuara parashikojne afate per njoftimin e autoriteteve te taksave per te punesuarit e rinj dhe rriten gjobat lidhur me keto mosdeklarime. Afati i deklarimeve eshte kufizuar ne 24 ore para dites se pare te punes ne vend te 48 oreve parashikuar ne dispozitat e meparshme. Ne rastet e mosnjoftimit ne afat, pervec detyrimit per pagimin e shumes se detyrimeve te papaguara (tatim mbi te ardhurat personale, sigurime shoqerore/shendetesore), subjekti detyrohet te paguaj edhe nje gjobe prej 50,000 lek kur eshte subjekt i biznesit te vogel dhe 100,000 lek per biznesin e madh me TVSH, per cdo rast mosdeklarimi.

Gjoha per mos perdorimin e pajisjeve fiskale dhe mos leshimin e kuponave fiskale (neni 10)

Ndryshimet e miratuara parashikojne gjoha te larta ne rastin kur evidentohet shkelje administrative lidhur me perdorimin e pajisjeve fiskale dhe leshimin e kuponave fiskale.

Konfiskimi i dokumentacionit ose paisjeve kompjuterike ku ruhen te dhenat (neni 12)

Ndryshimet e miratuara parashikojne qe ne rast se organet tatimore kane te dhena te besueshme qe tatimpaguesi fsheh informacion per gjendjen e tij ekonomike financiare, organet tatimore kane te drejte t'ia sekuestrojne dokumentacionin, pajisjet kompjuterike dhe fiskale dhe mjete te tjera te mbajtjes se dokumentacionit te tatimpaguesit ne mjediset e ushtrimit te veprimtarise se tij.

Hyrja ne fuqi

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

(Ligji No.10 209 date 23.12.2009 eshte publikuar ne Fletoren Zyrtare no.194 date 20 Janar 2010).

This information is provided as a guide only and should not be construed as advice. Professional accounting and tax advice should be sought before acting upon any of the point raised in this information.